



KRU. "GJAKOVA" SHA. Gjakovë			
Marrë në datën: 29.11.2019			
Njësia org.	Numri	Shitja	Vlera
	483		

Kompania Rajonale e Ujësjetës

*Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija*

RREGULLORE PER INICIMIN E PROCEDURES PERMBARIMORE TE ORGANI PERMBARUES

Nëntor 2019

Ne baze te nenit 7. pika 2. Statutit te K.R.U "Gjakova" Sh.A, me date _____ Bordi te Drejtoreve K.R.U "Gjakova" Sh.A, me seli ne Gjakovë, aprovoi kete:

RREGULLORE PER INICIMIN E PROCEDURES PERMBARIMORE TE ORGANI PERMBARUES

Neni 1

Me kete Rregullore rregullohen veprimet te cilat duhet te ndermerren brenda kompanise para pergatitjes se lendeve per procedim te Permbaruesi Privat (ne tekstin e metejme permbaruesi) , si dhe veprimet qe duhet te ndermerren brenda kompanise pas procedimit te permbaruesi.

Neni 2

Sherbimi per Konsumatore , para dorezimit te listes se konsumatoreve ne Njësia Ligjore , duhet te vertetoj qe te njejtat nuk jane ne procedure per ankesa/kerkesa ne kompani , dhe derisa nuk merret vendim nga kompania, te njejtat nuk munde te dorezohen ne Njësia Ligjore .

Neni 3

1. Problemet, kontestet , kerkesat dhe ankesat me konsumatore (lidhur me emrat e konsumatoreve , adresave te sakta, vdekja e konsumatoreve , nderrimi i shfrytzesit te sherbimeve ne nderkohe , dhe probleme te natyres se ngjashme) duhet te zgjidhen nga Sherbimi me Konsumatore para se lenda te procedohet ne Njësia Ligjore .
2. Ne rast se gjate zhvillimit te procedures rezultojne probleme te ketyre natyrave, zgjidhjen e tyre detyrohet ta beje Sherbimi per Konsumatore, me ry 'rast do ti ofroj deshmite Njësia Ligjore e cila ia percjelle organit kompetent.

Neni 4

Njësia Ligjore do ti pergatit propozimet per perrnbarim pas pranimit nga Sherbimit per Konsumatore lendet si dhe listen te nenshkruar , te vulosur dhe te protokolluar me te dhenat e sakta te konsumatoreve borxhlinj.

Neni 5

1. Njësia Ligjore nga Sherbimi per Konsumatore duhet ti dorezohen te gjitha lendet me shkresat e nevojshme per inicimin e lendeve te permbaruesi , dhe te njejtat duhet te jene origjinale apo kopje te vertetuara te vulosura dhe te nenshkruara.
2. Dokumentet e nevojshme te cilat pergatiten nga ana e Sherbimit per Konsumatore dhe i dorezohen Njësia Ligjore jane;
3. Fatura e fundit mujore e konsumatorit; Kartela e klientit (konsumatorit);
 - a) Certifikata e Biznesit per personat juridik , per bizneset individuale, ortakerite me

- pergjegjesi te kufizuar, ndersa per personat fizik duhet te sigurohet numri personal i konsumatorit nese kete e posedojne apo se paku emri i babes;
- b) Procesverbali i ekipit te kontrolles mbi gjendjen e konstatuar , duhet te jete i nenshkuar nga anetaret e ekipit te kontrolles, konsumatori apo anetari i ngushte i familjes se tij
4. Sherbimi per Konsumatore gjate procedures ne rast nevojje eshte i detyruar te siguroj dokumente shtese sipas kerkeses se permbaruesit apo gjykates.

Neni 6

1. Pas pranimit te listes se bashku me te gjitha deshmitet (dokumentet e nevojshme) , Njësia Ligjore ne afatin prej 7 (shtate) ditesh i pergatite propozimet per permbarim dhe te njejtat pas nenshkrimit dhe protokollimit i procedon te permbaruesi per vazhdimin e procedures se metutjeshme.
2. Permbaruesi pas pranimit te lendeve nga Njësia Ligjore , jep Urdhrin per lejimin e permbarimit te propozuar , pergatit pasqyren e fatures per secilin rast lidhur me shpenzimet procedurale , dhe te njejtën e percjelle te Njësia Ligjore , dhe kjo e fundit ja percjelle Sherbimit Financiar per ta kryer pagesen e fatures lidhur me shpenzimet procedurale.

Neni 7

1. Njësia Ligjore pas pranimit te ndonje kerkese nga gjykata apo permbaruesi , te njejtën e percjelle te Drejtori I Departamentit Administrativ , i cili e procedon te sherbimi perkates, dhe se ky sherbim ne afatin e parapare duhet te veprojsipas kerkeses.
2. Sherbimi perkates me shkrese duhet ta njoftoj Njësia Ligjore per veprimet e ndermarra sipas kerkeses, e cila pas verifikimit te rregullsise se shkreses, te njejtën ia percjelle gjykates apo permbaruesit.
3. Komunikimi ndermjet permbaruesit dhe sherbimeve perkatese te kompanise munde te behet edhe permes Email-eve (ne menyre elektronike).

Neni 8

1. Sherbimi me konsumatore ka per detyre te mbaje evidencen e lendeve te proceduara tek Njësia Ligjore , ndersa, Njësia Ligjore ka per obligim qe ta mbaje evidencen e lendeve te proceduara te organi permbarues.
2. Konsumatori pas pranimit te Urdhrit permbarimore nga permbaruesi, ka mundesi te beje marreveshje lidhur me pagesen e borxhit te kerkuar si ne propozimin per permbarim.

Neni 9

Kusht para nenshkrimit te marreveshjes (kontrates) per pagesen e borxhit nga konsumatori eshte pagesa e takses administrative ne lartesine e caktuar nga permbaruesi, perjashtimisht per rastet

specifike te cilet lirohen nga pagesa e takses administrative (rastet sociale, rastet e semundjeve), pas

konsultimit dhe lejimit nga Kryeshefi Ekzekutiv apo Drejtori I Departamentit Administrativ, per te cilen duhet te njoftohet Permbaruesi.

Neni 10

Sherbimi per Konsumatore eshte pergjegjes qe te kujdeset sipas detyres zyrtare qe mos ti procesoje te Njësia Ligjore konsumatorët e njejte me shume se nje here, ngase shpenzimet e bera bien ne barre te kompanine.

Neni 11

1. Permbaruesi, ne pajtim me konsumatorët i percakton kushtet e marreveshjes (kontrates) per pagesen e borxhit te kerkuar sipas propozimit per permbarim.
2. Pas marreveshjes se lidhur mes permbarusit dhe debitorit, permbaruesi duhet ta njoftoje Njësia Ligjore te Kompanise.

Neni 12

Njësia Ligjore duhet te mbaj kontakte te vazhdueshme me Permbaruesin lidhur me ecurine e lendeve te proceduara.

Neni 13

1. Pas pranimit te Urdhrit permbarimore nga Permbaruesi Privat debitori ka te drejte te paraqet Prapesim ne afat prej 7 (shtate) ditesh nga data e pranimit.
2. Njësia Ligjore pas pranimit te prapesimit nga permbaruesi ne afat prej 3 (tri) ditesh nga dita e pranimit te prapesimit, permes permbarusit per gjykatën themelore paraqet pergjigje ne prapesim.

Neni 14

1. Gjykata munde te vendos lidhur me prapesimin jashte seances gjyqesore.
2. Perjashtimisht gjykata munde te caktoj seance publike nese vleresohet se kjo eshte e domosdoshme per te kuptuar plotesisht validitetin e prapesimit.
3. Kunder aktvendimit te gjykates themelore palet kane te drejte te paraqesin ankese permes gjykates themelore per gjykatën e apelit te Kosoves ne Prishtine ne afat prej 7 (shtate) ditesh nga dita e pranimit te aktvendimit.
4. Pas pranimit te aktvendimit te ekzekutueshem nga gjykata, Njësia Ligjore fotokopjet e aktvendimit te ekzekutueshem ne kopje te mjaftueshme duhet ti percjelle Drejtori I Departamentit Administrativ te kompanise i cili i percjelle Sherbimit Financiar dhe Sherbimit per Konsumatore per veprim sipas aktvendimit te ekzekutueshem.

Neni 15

Nese gjate procedures permbarimore eshte e domosdoshme dalja ne teren e permbarusit per

dorezimin e propozimit per permbarrim , verifikimit te adreses se konsumatorit , verifikimin e konsumatorit ekzistues dhe nevojave-problemeve te ngjashme, kompania eshte e detyruar qe permbarruesit ti siguroj transportin , personat per asistim nga Sherbimi per Konsumatore per eliminimin e mangesive dhe problemeve gjate procedures.

Neni 16

Zyra Ligjore pas dorezimit te lendeve te permbarruesi eshte e obliguar qe kete liste ta dorezoj te Udhëheqësi I Shitjes per intervenim dhe nderhyrje ne kartelat e klientit me evidentimin qe lenda eshte proceduar te Permbarruesi.

Neni 17

Lenda do te konsiderohet e perfunduar dhe do te arkivohet vetem pas njoftimit nga ana e permbarruesit pas permbushjes se pageses se borxhit te kerkuar me propozimin per permbarrim si dhe pageses se taksave.

Neni 18

Interpretimin e kesaj Rregulloreje e bene Njësia Ligjore e K.R.U. "Gjakova" Sh.A.

Neni 19

Kjo Rregullore hyn ne fuqi pas nenshkrimit nga Kryesuesi i Bordit te Drejtorëve.

Datë 29 / 11 / 2019
Gjakovë

